

Emri i Lëndës : Zhvillimi i Kompetencave Ndërkulturore në Mësimdhënie							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ELL 541	C	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Albana Cekrezi, PhD					
Asistenti		Rudina Çinari, Msc					
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Ky kurs shqyrton fushën e edukimit ndërkulturor dhe trajtimin e këtij koncepti në përputhje me teoritë që e përbëjnë këtë fushë. Ky kurs është i vlefshëm për mesuesit e ardhshëm që japin mësim në mjedise multikulturore të brendshme si dhe në programet arsimore ndërkombëtare, por jo vetëm. Kursi u jep mundësinë studenteve të gjejnë dhe zhvillojnë metodologji efektive për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Gjithashtu, nepermjet këtij kursi studenteve u ofrohet mundësia për të ndërthurur kompetencat gjuhësore dhe ndërkulturore për një përvetësim më të mirë të gjuhës së huaj.					
Objektivat		Ne përfundim të lëndës, studentet duhet të dijnë të : Hartojnë dhe zbatojnë aktivitete mësimore ndërkulturore që rrisin kompetencën kulturore të nxënësve. Përshtasin metodat e mësimdhënies dhe komunikimin në klasë për të angazhuar në mënyrë efektive nxënësit të ndryshëm. Vlerësojnë në mënyrë kritike materialet mësimore për përfaqësimin kulturor dhe gjithëpërfshirjen. Demonstrjnë fleksibilitet, ndjeshmëri dhe ndjeshmëri kulturore në mjediset arsimore. Zhvillojnë dhe vlerësojnë kompetencën ndërkulturore të nxënësve përmes të mësuarit ndërveprues dhe me përvojë.					
Konceptet Kryesore		Kulture, Identitet, Kompetence, Vetëdije , Mësimdhënia, Edukimi, Nderkulturor					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në kurs. Prezantimi i lëndës dhe koncepteve bazë. Në këtë sesion studentët njihen me përmbajtjen e lëndës, konceptet dhe termat kyçe, objektivat, planprogramin, rezultateve të të nxënësve dhe format e vlerësimit. Një diskutim i shkurtër mbi konceptin e kompetencës ndërkulturore						
2	Koncepti i kulturës dhe identitetit. Komponentët e kompetencës ndërkulturore. Studentët njihen me konceptet kyçe të lëndës. Diskutohet teoria e Ajsbergut të Kulturës. Komponentët e kompetencës ndërkulturore janë ato që pasojnë diskutimin. Burimi: Developing intercultural competence through education, Edited by Josef Huber and Christopher Reynolds. Council of Europe 2014						
3	Ndjeshmëria ndërkulturore. Fazat e ndjeshmërisë ndërkulturore, Modeli i Milton Benet, 2017. Leksioni bazohet në këtë Burimi: "Milton Bennett, "Developmental Model of Intercultural Sensitivity," International Encyclopedia of Intercultural Communication]						
4	Zhvillimi i Marrëdhënieve Ndërkulturore. Leksioni është i fokusuar në këto çështje: • Pse është e rëndësishme zhvillimi i marrëdhënieve ndërkulturore? • Si të ndërtojmë dhe të mbajmë marrëdhëniet ndërkulturore. Keqkuptimet • Përdorimi i një sistemi komunikimit dhe marrëdhëniet ndërkulturore Burimi: INTERCULTURAL COMMUNICATION FOR THE COMMUNITY COLLEGE (SECOND EDITION) KAREN KRUMREY, May 2019. fq. 84-121						
5	Stereotipet dhe incidentet ndërkulturore. Ky leksion fokusohet në çështjet e mëposhtme: Koncepti i Steriotipit. Krahësimi i disa stereotipeve të disa kombeve të caktuara Krahësimi i rasteve incidenteve ndërkulturore. Diskutim dhe analizim rastesh Burimi: Critical Incidents for Intercultural Communication An Interactive Tool for Developing Awareness, Knowledge, and Skills", S. Apedaile and L. Schill. NorQuest College Intercultural Education Programs, 2008						

6	Kultura dhe Mesimdhënia Kompetenca e mësimdhënies ndërkulturore. Ky leksion paraqet një model për Kompetencën e Mësimdhënies Ndërkulturore (ITC) që studentët (mësuesit e ardhshëm) mund ta përdorin si një mjet për reflektim ndërsa përgatiten për të lehtësuar të mësuarit nëpër kultura. Ky model përbëhet nga 20 kompetenca të mësuesit të grupuara në tri kategori: aftësi themelore, aftësi lehtësuese dhe aftësi për zhvillimin e kurrikulës për të mësuarit ndërkulturore. Burimi: Dimitrov, N. & Haque, A. (2016). Intercultural Teaching Competence: A Multidisciplinary Framework for Instructor Reflection. Intercultural Education: Learning at Intercultural Intersections. 27(5). 437-456. doi:10.1080/14675986.2016.1240502
7	Qasje dhe aktivitete që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Ky leksion fokusohet në gjetjen e metodave dhe shembujve konkretë që do të përdoren në mjediset e klasës për të ndihmuar studentët të zhvillojnë kompetencën ndërkulturore. Përdorimi i shembujve ilustrues nga materiali: Developing intercultural competence through education, Edited by Josef Huber and Christopher Reynolds. Council of Europe 2014. Pg.34,
8	Provimi gjysmë final
9	Kompetenca ndërkulturore në gjuhët e huaja. Ky leksion është fokusuar në shpjegimin e konceptit të zërit ndërkulturore origjina dhe zbatimi e tij në mësimin e gjuhës së huaj. Burimi: Kapitulli 18. The Sage Hand Bok of Intercultural Communication, 2009
10	Kuadri European i Referencave për Kompetencën komunikuese ndërkulturore (ICC). Diskutimi bazohet në konceptin e Kornizës së Përbashkët Evropiane të Kompetencave për Gjuhët që të gjitha kompetencat njerëzore (kompetenca ndërkulturore ndër më të rëndësishmet) kontribuojnë në një mënyrë ose në një tjetër në aftësinë e përdoruesit të gjuhës për të komunikuar dhe mund të konsiderohen si aspekte të kompetencës komunikuese. Burimi: Common European Framework of Competences for Languages Language Policy Unit, Strasbourg. Chapter 5. Fq. 101
11	Mësimdhënia e kompetencave ndërkulturore. Efektet e arsimit në zhvillimin kulturor. Leksioni përqendrohet në idenë se edhe pse kompetencat ndërkulturore mund të fitohen përmes përvojës personale, është e nevojshme të hartohen shumë programe për të ofruar mësimdhënie ose trajnim formal pasi ato janë një ndihmë thelbësore. Burimi: Intercultural Competences. Conceptual and Operational Framework, UNESCO 2013
12	Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore, "Story Circles". Ky leksion paraqet një metodologji të strukturuar dhe fleksibël për zhvillim kompetenca ndërkulturore në një sërë kontekstesh, formale dhe joformale dhe jep një përshkrim të procesit të zgjedhjes së një mjeti për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. "Story Circles" u krijuan si një mjet praktik ndërkulturore për zhvillimin dhe ushtrimin e kompetencave ndërkulturore që mund të përdoren me grupe të ndryshme njerëzish. Burimi: Manual për Zhvillimin e Kompetencave Ndërkulturore, Darla K. Deardorff, Routledge 2020
13	Aktivitetet duke përdorur metodën e "Story Circles". "Story Circles" ofrojnë një mënyrë që njerëzit me prejardhje të ndryshme të bashkohen për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të eksploruar ngjashmëritë dhe dallimet kulturore. Në këtë leksion ne japim shembull konkret me studentët që formojnë një grup të vogël dhe luajnë role për të praktikuar metoden e "Story Circles" Burimi: Manual for Developing Intercultural Competencies, Darla K. Deardorff, Routledge 2020
14	Vlerësimi i Kompetencës Ndërkulturore: Problematikat dhe Mjetet matëse. Ky leksion ofron një shpjegim të qartë të asaj që në fakt duhet të jetë fokusi i vlerësimit ndërkulturore i ndjekur nga këto çështje: Cilat janë aftësitë përkatëse për t'u vlerësuar në kuadër të kompetencës ndërkulturore? A trajtohen siç duhet në përpjekjet për edukim dhe trajnim? A ka një lidhje të qartë midis mësimdhënies dhe vlerësimit? A po vlerësojmë atë që ka vërtet rëndësi? A ka përafrim ndërmjet objektivave mësimore, hartimit dhe zbatimit të kursit dhe vlerësimit? Burimi: The SAGE Handbook of Intercultural Competence, Chapter 27 Assessing Intercultural Competence 457 458 PART III RESEARCH AND ASSESSMENT IN INTERCULTURAL COMPETENCE
15	Përsëritje
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Developing intercultural competence through education Series editor Josef Huberm / Edited by Josef Huber and Christopher Reynolds. Council of Europe 2014 • Intercultural Competence, Conceptual and Operational Framework/Published in 2013 by UNESCO • Deardorff Darlra.K. Manual for Developing Intercultural Competencies-Story Circles Routledge.2020 UNESCO • The SAGE Handbook of Intercultural Competence. Edited by Deardorff Darlra.K.. Sage, London 2009 • Intercultural learning Classroom activities
Referenca të tjera	• Common European Framework of Competences for Languages Language Policy Unit, Strasbourg • Dimitrov, N. & Haque, A. (2016). Intercultural Teaching Competence: A Multidisciplinary Framework for Instructor Reflection. Intercultural Education: Learning at Intercultural Intersections • Milton Bennett, "Developmental Model of Intercultural Sensitivity," International Encyclopedia of Intercultural Communication. 2017 • Critical Incidents for Intercultural Communication An Interactive Tool for Developing Awareness, Knowledge, and Skills", S. Apedaile and L. Schill. NorQuest College Intercultural Education Programs, 2008 • INTERCULTURAL COMMUNICATION FOR THE COMMUNITY COLLEGE (SECOND EDITION) KAREN KRUMREY, May 2019. Pg. 84-121
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët janë të aftë të njohin modelet dhe vlerësimin e kompetencës nderkulturore
2	Studentët janë të aftë të zhvillojnë aftësi në analizimin dhe vlerësimin kritik të rasteve dhe incidenteve ndërkulturore
3	Studentët janë të aftë të përdorin metodologji për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	3	30	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	10	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	1	1
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			145
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.80
ECTS			6.00